

MANUAL PER PYETSORIN E KOMUNITETIT LSMS 2005

Disa sqarime per menyren e anketimit te Pyetsorit te Komunitetit

Ju keni ne dore Pyetsorin e Komunitetit qe do te intervistohet ne zonat urbane dhe rurale te cilave iu ka rene shorti i LSMS.

Udhezime te pergjithshme

- o Ne çdo zone ku ka rene shorti per LSMS, do te intervistohet edhe ky Pyetsor.
- o Per cdo zone lidhuni me Kryetarin e Komunitetit (kryetarin e bashkise, minibashkise, apo rajonit perkates) per te dhena te pergjithshme qe kane te bejne me komunitetin qe do te intervistoni.
- o Eshhte e nevojshme prania e te pakten dy personave te tjere qe kane te bejne me shendetin, arsimin, infrastrukturen, etj.
- o Ne ato raste kur nje PSU eshte e ndare ne dy ose me shume fshatra ju do te beni aq intervista sa fshatra jane ne perberje te PSU.
- o Ne zonat urbane nje pyetsor i komunitetit mund te mbuloje me shume se nje PSU.
- o Nese dalin probleme gjate intervistes mbajini shenim dhe kontaktoni me stafin LSMS.

Udhezime te veçanta

Kapaku

Ne krye, kutia lart majtas lihet bosh. Vazhdoni me emrin e Rrethit, te Bashkise/Komunes dhe emrin e fshatit ose qytetit perkates. Psh:

Rrethi Korçe
Komuna Maliq
Fshati Bicke

Shenoni daten e vizites ne komunitet, ne tabelen poshte. Nese me shume se nje vizite sheno datat per çdo njeren prej tyre.

Seksioni 1A

Me komunitet kuptojme nje minibashki, fshat apo rajon te caktuar.

Ne pjesen e pare te ketij seksioni marrim informacion se ne ke komunitet po zhvillohet intervista, sa banore ka ky komunitet dhe sa banore jetojne ne kete qytet.

Seksioni 1B

Kerkon informacion per personat qe pergjigjen. Kujdes, ndiqi pyetjet me radhe.

KUJDES:

Eshte mire qe ne grupin e njerezve qe do te intervistoni te kete nje punonjes arsimi, nje punonjes bujqesie, nje punonjes shendetesie, perfaqesues te Zyres se Punes, arsimtar ose drejtor shkolle etj.

Prania e tyre kerkohet sepse edhe pyetjet tona kane lidhje me probleme qe mbulojne keta persona.

Ketu merret informacion per moshen e tyre, gjinine, pozicionin ne kete komunitet dhe prej sa vjetesh jane ne kete pozicion, arsimimi i tyre dhe sa kohe kane qe jetojne ne kete komunitet.

Seksioni 2

Ne kete seksion mblidhen te dhena mbi karakteristikat baze te komunitetit ne pergjithesi.
Nese grupi qe ju po pyesni nuk eshte ne gjendje te pergjigjet per popullsine e fshatit, mundohuni qe kete informacion ta merrni ne Komune ose Bashki.

Seksioni 3A

Ketu pyetet per aksesin ndaj sherbimeve publike ne komunitet.

Kujdes:

Nese pergjigja ne pyetjen 1 eshte **PO**, vazhdo me rreshtin tjeter.

Pyetjet nga 2-5 behen ne rastet kur pergjigja tek pyetja 1 eshte JO.

Nese distanca eshte me pak se 1 km, sheno me presje dhjetore.

Ne Pyetjen 4 jepni vetem nje pergjigje.

Seksioni 3B

Ky seksion plotesohet kur ne seksionin 3, pyetja 1 per shkollat, eshte PO.

Seksioni 3C

Ky seksion plotesohet kur ne seksionin 3, pyetja 1 per ambulancat/qendrat shendetsore, eshte PO.

Seksioni 3D

Ky seksion ka te beje me cilesine e transportit publik. Interesohemi per transportin publik qe lidh komunitetin me zona te tjera.

Seksioni 4A dhe Seksionet 4A e 4B

Ka te beje me sherbimet baze si furnizimi me energji elektrike, uje te rrjedhshem, heqjen e plehrave, kanalizimet, etj.

Ne radhe te pare pyetet nesa ka apo jo sherbim sipas listes, dhe nese po cilesia e ketyre sherbimeve baze per komunitetin.

KUJDES:

Tek seksioni 4B, pyetjet 3 dhe 4: - tek pyetja 3 pyetet po ose jo

Tek pyetja 4, shenohen dy metodat kryesore te mbledhjes se plehrave

Seksioni 5, 5A dhe 5B

Interesohemi per organizatat qe operojne ne komunitet si dhe per aksionet kolektive qe kryen ne sherbim dhe per te miren e komunitetit.

Seksioni 6

Interesohemi per gjendjen e rendit ne komunitet.

Kujdes: tek pyetja 2 nese asnje PO kalo tek seksioni 7.

Seksioni 7

Tek pyetja 6, sheno dy aktivitetet me te rendesishme.

Seksioni 8

Interesohemi per Fondin e zhvillimit.

Seksioni 9

Interesohemi per probleme te ndotjes se ambientit dhe te semundjeve/ epidemive ne komunitet.

Seksioni 10

Ne pyetjen 1 nese e ndjeni qe I anketuari nuk ka burime te marrjes hua shenoni : “Nuk disponon asnje burim huaje”.

Kini gjithashtu kujdes te shenoni vetem 3 burimet kryesore.

